

Demokracia kushtetuese



nga Sokol Berberi

**Universiteti European i Tiranës
Fakulteti i Drejtësisë**



Nga forca te e drejta: nga pushteti totalitar(despotizimi) te kufizimi i pushtetit

- Ideja e një politike që i nështrohet ligjit, dhe jo forcës, përshkon historinë mijëravjeçare të mendimeve politike të njerëzimit. Evolucioni i Perëndimit prej shekujsh nxjerr në pah progresin e formave konstitucionale, në dëm të formave autokratike apo arbitrare të qeverisjes.



Demokracia kushtetuese

- Demokracia kushtetuese është një sistem politik hibrid që bazohet në një bashkim të teorive politike normative që janë zakonisht të pajtueshme, por bashkëjetojnë në një gjendje tensioni dhe, sipas rasteve, në një konflikt të hapur. Në rrënjë ato kanë të përbashkët një vlerë themelore: respektin për dinjitetin e të gjitha qenieve njerëzore. Konstitucionalistët dhe përfaqësuesit e teorive demokratike ndahen në shumë pika, por ata dakortësohen se qeveria/qeverisja, shoqëria dhe qytetarët janë të detyruar t'i trajtojnë të gjithë individët me respekt të njëjtë dhe të duhur.
- Letrat e Federalistit: Debati ndërmjet Madison/Hamilton dhe Jefferson

Idetë liberale si frymëzuese të konstitucionalizmit

- Benzhamen Konstani verente se, per ithtaret e lirise "negative" individuale, problemi kryesor nuk ka te beje me llojin e subjektit qe ushtron pushtetin, por me masen e pushtetit qe duhet lene ne duart e ketij apo atij subjekti. Vertet, ai qe zoteron nje pushtet te pakufizuar ka per ta ushtruar ate, heret a vone, per te shkaterruar individin. Sipas tij, njerezit zakonisht revoltohen kundra njeres apo tjetres qeveri, duke e konsideruar si shkaktare te shtypjes, ndersa shkaku i vertete qendron thjesht ne faktin e akumulimit te pushtetit, nuk ka rendesi ne duart e kujt, sepse liria rrezikohet nga vete ekzistenca e autoritetit absolut si i tille. "Nuk eshte puna se krahu qe mban armen e perdor ate padrejtesisht", shkruante ai, " por vete arma eshte teper e rende- e papershtatshme per t'u mbajtur nga duart njerezore".



“Triumfi” i konstitucionalizmit

- Vendet e Europës perëndimore si dhe demokracitë e tjera të konsoliduara pajtohen me këndvështrimin se demokracia duhet të mbrojë veten nga tirania e pushtetit të shumicës nëpërmjet konstitucionalizmit dhe kontrollit gjyqësor.
- Zhvillimet historike, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, në mbështetje të konstitucionalizmit



Demokracia

- Liberalizimi nuk është i njëjtë me demokratizimin. Për definimin e termit të fundit, së pari duhet të përqëndrohemi në veçorinë esenciale të demokracisë si formë e organizimit politik. Kjo veçori i referohet pasigurisë: në demokraci, rezultatet e procesit politik, në një farë mase, janë të papërcaktuara për sa i përket pozicioneve që zënë pjesëmarrësit në të gjitha marrëdhëniet shoqërore, duke përfshirë marrëdhëniet e prodhimit dhe institucionet politike.
- Në demokraci askush nuk mund të jetë i sigurtë se interesat e tij përfundimisht do të triumfojnë.
- Në demokraci, të gjitha forcat, detyrimisht, në mënyrë të përsëritur, duhet të luftojnë për realizimin e interesave të tyre, përderisa askush nuk është i mbrojtur për shkak të pozitës së tij. Askush nuk mund të shpresojë për modifikimin e rezultateve *ex post*; secili duhet t'ia nënshtrojë interesat e tij konkurrencës dhe pasigurisë.



Elementet e konstitucionalizmit

- Ideja e konstitucionalizmit shprehet kryesisht nëpërmjet kushtetutës së shkruar, ndarjes së pushteteve, shtetit të së drejtës dhe kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve. Duke rregulluar garantimin e të drejtave, ndarjen e pushteteve si dhe një përfaqësim politik të qytetarëve, Kushtetuta vendos një sistem që synon mbrojtjen e lirisë individuale dhe kufizimin e pushtetit .
- “Si përkufizim, shkruan Carl Friedrich, demokraci e tipit kushtetues është ajo demokraci që nuk ia jep “gjithë” pushtetin shumicës”.

La démocratie constitutionnelle, Paris, PUF, 1958, f.15.



Kushtetuta shqiptare

- Kushtetuta shqiptare, nga pikëpamja normative, ka vendosur një demokraci kushtetuese. Ky pohim është evidentuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila në një nga vendimet e saj, ndër të tjera, shprehet:
"Demokracia kushtetuese e vendosur me këtë Kushtetutë, bazohet në shtetin e së drejtës, parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut."(vendimi nr.12/2008).

Sovraniteti i popullit dhe kufizimi i pushtetit



- Gjykata Kushtetuese është shprehur se në një shtet kushtetues, të gjitha pushtetet përballen me detyrime dhe kufizime që burojnë nga Kushtetuta, duke përfshirë edhe vetë popullin në ushtrimin e sovranitetit drejtpërsëdrejti.
- Sovraniteti i popullit, i vendosur në kuadrin e një sistemi kushtetues e ligjor, nuk mund të ngatërrohet me pushtetin themelor, dhe kërkesa për të ndjekur disa procedura të veçanta gjatë ushtrimit të tij është tërësisht në përputhje me sovranitetin popullor. Kushtetuta e Shqipërisë e ka lidhur në mënyrë të qartë ushtrimin e sovranitetit popullor me respektimin e disa rregullave të veçanta.
- Shih vendimin 25/2009 të GJK-së.

Sovraniteti parlamentar dhe kufizimi i pushtetit



- Në raportin e Komisionit hetimor parlamentar "Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për nisjen e procedurës për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm", në vitin 2007, në faqen 13, përmendet: "...është detyrë e Kuvendit të Shqipërisë me ***cilësinë e sovranit***, të marrë masa dhe të kontrollojë funksionimin e organeve kushtetuese, të shohë nëse ato janë në gjendje të përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e tyre profesionale dhe ligjore, (Rekomandim i KE 2000/19) dhe në rast se verifikon se ky mision i tyre nuk është përmbushur të ndërhyjë për të bërë të mundur mirëfunksionimin e sistemit."

Sovraniteti parlamentar dhe kufizimi i pushtetit

- Parimi i deklaruar në nenin 2 të Kushtetutës se “Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve tij ose drejtpërsëdrejti” nuk duhet kuptuar si synim i kushtetutbërësit për t’i atribuuar Kuvendit statusin e organit superior/suprem në raport me pushtetet e tjera kushtetuese. (vendimi nr.12/2008).
- Sistemi parlamentar, si nocion, nuk nënkupton pranimin e modelit britanik të sovranitetit parlamentar. Sipas doktrinës të sovranitetit parlamentar, parlamenti është i lirë të miratojë çdo ligj që ai e konsideron të nevojshëm, është i pakufizuar nga vendimet legjislative të mëparshme dhe gjykatat nuk mund të vënë në diskutim vlefshmërinë e ligjeve, as t’i shfuqizojnë ato.
- Albert V. Dicey, *The law of the constitution*, bot. i tetë, 1915.



Roli i Kushtetues

- Kushtetuta, si *pactum societatis*, kuptohet si kusht paraprak për një bashkëjetesë civile, paqësore dhe konstruktive. Gjithashtu, Kushtetuta, si ligj themelor, përveç vendosjes së rregullave mbi të cilat bazohet dhe ushtrohet pushteti politik, mëshiron vlerat dhe parimet thelbësore të qeverisjes, që vetë shoqëria i pranon, dhe aspiratat e saj më të larta për të ardhmen. Ato janë të përfshira në Kushtetuta, para së gjithash, si deklarata të vullnetit për të qenë pjesë e një civilizimi juridik, me tradita, shpeshherë, shumë-shekullore, dhe e “familjeve” kushtetuese ku bëjnë pjesë shumë kombe.



Kufijtë kushtetues

- **Kufijtë kushtetues materialë/substancialë: të drejtat e njeriut**
- **Kufijtë kushtetues strukturorë dhe procedurëlë: ndarja e pushteteve, organizimi dhe vendimmarrja**
- **Procesi demokratik/zgjedhjet/pluralizmi**



Kontrolli kushtetues dhe legjitimiteti

- Si të kontrollojmë respektimin e kufijve kushtetues/kufizimin e pushtetit?
- Gjykata Kushtetuese është ngarkuar nga Kushtetuta me rolin parësor të garantimit dhe interpretimit përfundimtar të saj. Ky institucion, i cili është ngritur pothuajse në të gjitha vendet europiane pas Luftës së Dytë Botërore dhe, më vonë, pas rënies së komunizimit, përfaqëson një nga zhvillimet më të rëndësishme të konstitucionalizmit.
- Gjykata Kushtetuese është rojë e *pactum societatis*, garanci e kushteve më minimale të jetës kolektive. Asaj i takon mbrojtja e parimeve kushtetuese për të cilët “nuk mund të votohet”.
- Në thelb, çështja e legjitimitetit demokratik të gjyqtarit kushtetues futet në problematikën e asaj që quhet ndarje e pushteteve, në këndin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor ose, më përgjithësisht, në funksionin juridiksional i cili përbën garancinë më të sigurtë për ekzistencën e shtetit të së drejtës.

Ngurtësia e Kushtetutës dhe “Kushtetuta e gjallë”

- Një kushtetutë e gjallë është ajo që evoluon, ndryshon kuptimin e saj me kalimin e kohës dhe përshtatet në rrethana të reja, pa u amenduar formalisht. Bota është e përfshirë në një proces të vazhdueshëm ndryshimi politik, ekonomik, shoqëror dhe teknologjik të cilin kushtetutëbërësi nuk mund ta parashikojë kur harton Kushtetutën. Ndaj nuk është realiste të presësh që procesi i ndërlikuar amendues të ndjekë këto ndryshime. Kështu, duket e pashmagshme që edhe Kushtetuta do të ndryshojë.
- Nga ana tjetër, ideja e Kushtetutës së gjallë, që ndryshon jo nëpërmjet procedurës amenduese, nuk mund t’i shmanget kritikave dhe kundërshtive të forta dhe të kuptueshme. Kushtetuta shihet si një themel solid, mishërim i parimeve dhe rregullave më themelore, e cila supozohet të jetë e ngurtë dhe e qëndrueshme për një kohë të gjatë, çka nënkupton në vetvete idenë e të pasurit një kushtetutë.

Debati rreth konceptit të “Kushtetutës së gjallë”

- Koncepti i “Kushtetutës së gjallë”, veçanërisht në SHBA, ka provokuar një nga debatet kushtetuese bashkëkohore më të rëndësishëm. Ky debat lidhet me pyetjen nëse kuptimi i tekstit të Kushtetutës mund të evoluojë nën dritën e rrethanave aktuale apo Kushtetua duhet të interpretohet në përputhje me kuptimin që i është dhënë tekstit fillimisht nga publiku që e ratifikoi atë. Tradicionalistët/orgjinalistët i referohen të shkuarës, si një burim për të zgjidhur problemet bashkëkohore, ndërsa realistët/progresistët theksojnë nevojën për realizëm nën dritën e kushteve të reja të krijuara.
- Sipas mbështetësve të idesë së Kushtetutës së gjallë, hartuesit e Kushtetutës kanë folur me maturi në gjuhën e përgjithshme dhe ia kanë lënë brezave të ardhshëm detyrën e aplikimit të gjuhës së Kushtetutës në mjedisin ku ata jetojnë, i cili është vazhdimisht në ndryshim.



Kufijtë e kontrollit kushtetues

- Teksti i kushtetutës
- Kufizimet procedurale: vënia në lëvizje; legjitimimi; juridiksioni etj..
- Precedenti
- Detyrimet etike

Pavarësia e Gjykatës

“...pavarësia e gjyqtarëve mund të jetë garanci thelbësore ndaj pasojave të depresioneve të rastësishme të shoqërisë jo vetëm në rastin e shkeljeve të Kushtetutës. Nganjëherë këto shkelje nuk janë më shumë sesa cenime të të drejtave private të kategorive të veçanta të shtetasve për shkak të ligjeve të padrejta dhe të njëanshme. Këtu vendosmëria e gjykatës ka rendësi të madhe për të zbutur ashpërsinë dhe për të kufizuar veprimin e ligjeve të tilla. ... Përfitimet nga paanshmëria dhe moderimi i pushtetit gjyqësor tashmë janë ndjerë në mëse një shtet dhe ndonëse ato mund t’u kenë prishur qejfin atyre, shpresat ogurzeza të të cilëve kanë zhgënjyer, ato kanë fituar respektin dhe miratimin e të gjithë njerëzve të ndershëm dhe të paanshëm. Çdo njeri i matur duhet të çmojë gjithçka që synon të krijojë ose të forcojë këtë frymë në gjykatat, pasi askush nuk mund të jetë i sigurt se nesër nuk do të jetë viktim e frymës së padrejtësisë, paçka se sot ai mund të nxjerrë ndonjë përfitim prej saj. Çdo njeri duhet ta ndjejë tani se prirja e pashmangshme e kësaj fryme [të padrejtësisë] është gërryerja e themeleve të besimit publik dhe privat dhe zëvendësimi i tij me mosbesimin dhe pasigurinë e përgjithshme.”

Aleksandër Hamilton; Letrat e Federalistit, 78



Kush do të ruajë rojen?

- Si me çdo kompetencë që i atribuohet një organi shtetëror që nuk ka asnjë mundësi për të qenë i vetë kontrolluar, kontrolli kushtetues mund shtrembërohet dhe të abuzohet, pa asnjë mundësi për qytetarët apo organet e tjera kushtetuese për të kontrolluar veprimet e tyre. Pyetja kryesore që gjithmonë do të mbetet për t'u shtruar për çështjen e abuzimit të juridiksionit kushtetues është "*Quis ipso custodiem?*" (kush do t'i kontrollojë gardianët?) Kjo është e rëndësishme të kihet parasysh, veçanërisht në regjimet demokratike, ku shndërimi i Gjykatave Kushtetuese në ligjvënës shkel parimin e ndarjes së pushteteve dhe transformon ato në organet shtetërore që nuk i nënshtrohen përgjegjësisë politike.